

PROCESVERBAL
nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 30.3.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Goran Radunović, mr. Magdalena Davidovska- Dogleva, Maja Damevska .

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 12-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 14:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, propozoi pika 7 e Rendit të ditës me titull "Propozim-qëndrim i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në lidhje me rezultatin e revizionit të kryer nga revizor i pavarur për vitin 2025", të jetë pika 4, ndërsa pikat e mbetura duhet të rinumërohen në përputhje me rrethanat , përkatësisht të zhvendosen një vend përpara.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjuar si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 5-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 23.3.2026.
2. Miratimi i Propozim- procesverbalit të seancës së 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 23.3.2026.
3. Miratimi i Propozim- procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 25.3.2026.
4. Propozim-qëndrim të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në lidhje me rezultatin e revizionit të kryer nga revizor i pavarur për vitin 2025.
5. Propozim – raporti vjetor mbi punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.
6. Informacion në lidhje me ndryshimin e përcaktuar të strukturës pronësore të ShTR TV Shutel.

7. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizion Plus ShPK Kumanovë.
8. Të ndryshme .

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 5-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 23.3.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 23.3.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Këshilli shqyrtoi dhe me një votë "abstenim" nga mr. Gordana Majnova dhe 6 vota "pro" miratoi procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 25.3.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi qëndrimin e propozuar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në lidhje me rezultatin e revizionit të kryer nga revizori i pavarur për vitin 2025. Ai sqaroi se, në përputhje me detyrimet ligjore, Agjencia çdo vit angazhon revizor të pavarur për të kryer analizë të punës për vitin e kaluar dhe përcaktimin e qëndrimit në lidhje me raportin e revizionit. Në këtë drejtim, informoi Këshillin se është paraqitur propozim-qëndrim me të cilin Agjencia pajtohet me mendimin që përmban Raporti i revizionit për vitin 2025, sipas të cilit Raportet financiare objektivist në të gjitha aspektet materiale paraqesin gjendjen financiare të Agjencisë për periudhën në fjalë. Njëkohësisht, drejtori theksoi se Agjencia nuk pajtohet me mendimin rezervë të shprehur nga revizori i pavarur në pjesën që i referohet vlerës së tokës në ndërtesë, duke marrë parasysh që e njëjta është regjistruar në bilanci me rekomandim të Entit Shtetëror të Revizionit. Prandaj lidhur me këtë, u propozua që ky qëndrim të rishikohet dhe të miratohet nga Këshilli, pas së cilës i njëjti do të përfaqëson pjesë përbërëse të Raportit vjetor të punës së Agjencisë për vitin 2025, i cili do t'i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilli i Agjencisë në lidhje me rezultatet e revizionit të kryer për vitin 2025 nga Shoqëria e Revizionit dhe Konsulencës së Biznesit A&BA Group ShPKNJ P Shkup, njëzëri përcaktoi qëndrimin në vijim të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele:

- Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele pajtohet me mendimin e Raportit të revizionit për vitin 2025, e vërtetuar në arkivin e Agjencisë me nr.02-1044/2 datë 17.3.2026, se raportet financiare objektivist në të gjitha aspektet materiale përfaqësojnë gjendjen financiare të Agjencisë që nga data 31.12.2025;

- Në lidhje me pjesën " Baza për mendim me rezervë " që i referohet vlerës së tokës në ndërtesë, Agjencia nuk pajtohet, për shkak se e njëjta është regjistrua në bilancet me rekomandim të Entit Shtetëror të Revizionit.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, do ta publikojë qëndrimin e lartpërmendur në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika a 5

Drejtori Trajçevski shpjegoi propozimin e Raportit vjetor të Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025. Ai shpjegoi se Këshilli i Agjencisë, në seancë e mbajtur më 23 mars, miratoi këtë dokument në draft-verzion. Në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, 31 marsi është afati i fundit për të cilën Agjencia është e detyruar të dorëzojë Raportin në formën përfundimtare. Ndërkohë, është theksuar se nuk janë paraqitur vërejtje ose propozime në lidhje me draft-tekstin. Duke marrë parasysh sa më sipër, drejtori propozoi Raportin vjetor të miratohet në formë identike si draft-verzion.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, iu referua Raportit të propozuar të Punës së Agjencisë për vitin 2025 dhe vuri në dukje se Raportin përfaqëson dokument gjithëpërfshirës dhe sistematik që në mënyrë të qartë tregon aktivitetet e realizuara dhe kompetencat ligjore të Agjencisë gjatë vitit të kaluar. Ai përshëndeti praktikën e vendosur dhe fillimisht Raportin të shqyrtohet si draft-verzion para miratimit të tij përfundimtar, sepse në këtë mënyrë lejohet hapësirë shtesë për harmonizim dhe përcaktim teknik të tekstit, me qëllim sigurimin e verzioni përfundimtar më cilësor. Deklaroi se Raportin përfshin segmente kryesore të punës së Agjencisë për vitin 2025, duke përfshirë dhe aktivitetet mbikëqyrëse, procedurat rregullatore, si dhe aktivitetet drejtuar avancimit të rregullativës mediatike dhe arsimimit mediatik, duke përfshirë pjesëmarrjen në proceset e ndryshimeve ligjore. Në lidhje me të dhënat e paraqitura, të njëjtat japin pasqyrë të qartë të aktiviteteve të realizuara, ku segmente të caktuara do t'i nënshtrohen monitorimi të mëtejshëm dhe në kuadër të punës së rregullt të Agjencisë. Në pjesën e punës financiare tregoi se të dhënat janë prezantuar në mënyrë transparente dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara, me pasqyrim të përshtatshëm të punës financiare gjatë gjithë vitit. Në përputhje me detyrimin ligjor, Raorti vjetor i punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 do t'i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afatin e përcaktuar dhe pritet që ai të shqyrtohet dhe vlerësohet pozitivisht, duke marrë parasysh mënyrën se si paraqiten aktivitetet, transparenca në punë dhe përmbushja në vazhdimësi e kompetencave ligjore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për miratimin e Raportit Vjetor të Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 (me Raport për realizimin e planit vjetor të mbikëqyrjes programore për vitin 2025 dhe Raport financiar për realizimin e planit financiar për vitin 2025 dhe Llogari vjetore me të ardhurat, shpenzimet, kërkesat dhe detyrimet për vitin 2025), me tekstin e propozuar.

Agjencia vepron në përputhje me nenin 8, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25)

dhe neni 11, paragrafi (2) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr. 01-3632/1 datë 22.8.2025.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 6

Drejtori Trajçevski shpjegoi Informacionin në lidhje me ndryshimin e përealizuar në strukturën pronësore të ShTR TV Shutel. Ai sqaroi se transmetuesi ka marrë leje nga Këshilli për ndryshim të strukturës pronësore, dhe në përputhje me aktin nënligjor, ndryshimi duhej të kryhej në Regjistrin Qendror në afat prej tre muajsh, përkatësisht të kryhet regjistrimi i ndryshimit që ndodhi. Gjatë kontrollit të kryer nga shërbimet u përcaktua se ndryshim i tillë nuk ishte evidentuar në Regjistrin Qendror. Duke marrë parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh që transmetuesi nuk ka zbatuar ndryshimin e miratuar në afatin e parashikuar, Këshilli i propozohet të pranoj Informacionin dhe të konstatoj se vendimi i Këshillit të Agjencisë, miratuar më 15.12.2025, i cili lejon ndryshim në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel ShPKNjP Shkup, nuk prodhon (paraqet) veprim juridik, sepse ndryshimi nuk është zbatuar në kohë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Plotësuese, drejtori propozoi, përveç njoftimit të transmetuesit, të njoftohet zyrtarisht dhe Regjistri Qendror, me qëllim për të parandaluar zbatimin eventual të ndryshimit në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Këshilli i Agjencisë e pranoi Informacionin në lidhje me ndryshimin e përealizuar të strukturës pronësore të ShTR TV Shutel, PA1 nr. 02-324 datë 26.3.2026 dhe njëzëri konstatoi se Vendimi i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele PA1 nr. 02 324 datë 15.12.2025, që lejon ndryshim në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuziv TV Shutel ShPKNjP Shkup, nuk prodhon veprim juridik, sepse ndryshimi në strukturën pronësore nuk është zbatuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afatin e përcaktuar në pikën 3 të Vendimit të lartpërmendur.

Të informohet Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ShTR TV Shutel ShPKNjP Shkup, në përputhje me Konkluzionin e Këshillit, Vendimin PA1 nr. 02-324 datë 15.12.2025 nuk prodhon veprim juridik, sepse ndryshimi në strukturën pronësore nuk është zbatuar në afatin ligjor prej 3 muajsh, i cili skadoi më 17.3.2026.

Pika 7

Drejtori Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë. Shpjegoi se transmetuesi nuk ka paguar kompensimin vjetor për transmetim televiziv në afatin ligjor, për këtë shkak propozohet iniciimi i procedurës për heqjen e lejes. Deklaroi se është realizuar komunikim me transmetuesin, gjatë të cilit u njoftua se detyrimi do të zgjidhet në afatit shtesë prej 15 ditësh.

Kryetari Stefanovski pyeti se kur fillon të rrjedh afati, nga ku drejtori Trajçevski u përgjigj se afati fillon nga dita e arkivimit të propozimit nga Këshilli, përkatësisht nga e mërkura e kaluar, nga ku mbeten edhe 11 ditë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë, PA1 nr. 08-626 datë 7.9.2023, për shkak të

mospërbushjes së detyrimit të nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht mospagesësë së kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e çprocedrës për heqjen e lejes, do miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë nr. 08-626 datë 7.9.2023, për shkelje të nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**